



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:082501

Datë: 12.08.2022

Numri i dokumentit: 03321891

PKR.nr.99/2021

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Islam Thaçi, me zyrtaren ligjore Adelina Brestovci- procesmbajtëse, kundër të pandehurit F. S., për shkak të veprës penale, falsifikimi i parasë, nga neni 296 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) të cilin e mbron, av. K. I., nga Gjilani, i caktuar sipas detyrës zyrtare, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda (PTHDKR) PP.I. nr.../ 2021, të dt. 20.05.2021, të cilën e përfaqësonte Prokurori i Shtetit Isuf Sadiku, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 04.08.2022, në prani të palëve, publikisht shpalli , ndërsa më datë 12.08.2022, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri F. S.. nga babai F. dhe nëna P., e lindur B. i lindur më, në Gjilan, me vendbanim në rr. “M.. I.”, nr..., me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Gjatë muajit shtator të vitit 2020, në Gjilan, i pandehuri duke e ditur se paraja është e falsifikuar e vë në qarkullim, në mënyrë që duke e ditur ka poseduar para të falsifikuara edhe atë bankënotën në vlerë prej 20€, me numër serik SF, e të cilën e vë në qarkullim si të vërtetë, ashtu që i pandehuri F. S. i ka furnizuar personat E. S. dhe M. Xh., të cilët edhe e kanë vënë në përdorim kartëmonedhën e falsifikuar si të vërtetë.

Me çka ka kryer veprën penale, falsifikim i parasë, nga neni 296 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipër theksuar ligjore si dhe neneve : 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71, dhe 72, të KPRK-së, si dhe nenit 365 dhe 453 të KPPRK-së, të pandehurin, e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzetë) ditëve, të cilën i pandehuri detyrohet që ta mbaj në afta prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Detyrohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, përkitazi paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzetë) Euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë) Euro, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konfiskohet kartëmonedha 1 x 20 me numër serik SF, e sekuestruar nga ana e policisë më datë 23.09.2020, dhe e njëjta shkatërrohet- asgjësohet në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi.

Njoftohet i pandehuri se për çdo ndërrim eventual të adresës së banimit, detyrohet që t'ia njoftoj gjykatën deri në përfundimin e procedurës penale.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate me datë 20.05.2021, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr../2021, kundër të pandehurit F. S., për shkak të veprës penale, falsifikimi i parasë, nga neni 296 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 04.08.2022, në të cilën kanë prezantuar: Prokurori i Shtetit Isuf Sadiku, si dhe i pandehuri F. S. me mbrojtësin, av. K. I. nga Gjilani , i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pasi që, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e shqyrtimit fillestar, në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, fillimisht të pandehurin e ka udhëzuar për të drejtat e tij për mos me u deklaruar përkitazi me çështjen e tij penale ose që të mos përgjigjet në pyetjet e parashtruara, mirëpo nëse i njëjti vendos që të deklarohet lidhur me çështjen penale, se nuk ka për detyrë që ta inkriminoj vetveten ose të afërmit e tij e as ta pranoj fajësinë, se për mbrojtës sipas detyrës zyrtare, gjykata të njëjtit i ka caktuar, av. K.I.

I pandehuri ka deklaruar se i kam të qarta të drejtat për të cilat më udhëzoi kryetari i trupit gjykues, duke u pajtuar që në seancën e shqyrtimit fillestar të mbrohem nga av, K.I. , të cilin gjykata ma ka caktuar.

Po ashtu i pandehuri është njoftuar lidhur me bene fitet ligjore për pranimin e fajësisë, natyrisht nëse plotësohen kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, e njëkohësisht edhe për pasojat e pranimit të fajësisë, dhe nëse pranohet fajësia e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet, nuk është e nevojshme për tu administruar provat në shqyrtim gjyqësor, por vetëm të vlerësohen, respektivisht shqyrtohen të njëjtat në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri F.S., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi veprën penale për të cilën akuzohet, duke e pranuar fajësinë për kryerjen e të njëjtës, në pajtim me përshkrimin faktik dhe kualifikimin juridik si në dispozitiv të aktakuzës lëndore.

Kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve lidhur me pranimin e fajësisë si dhe pasi që është bindur se janë vërtetuar të gjitha faktet relevante në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPPRK-së me provat e bashkangjitura aktakuzës lëndore, duke vepruar në kuptim të nenit 248 paragrafi 4 të

KPPRK-së me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale, falsifikimi i parasë, nga neni 296 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), sipas aktakuzës me numër dhe datë të shënuar si më lartë.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Kryetari i trupit gjykues, ka konstatuar se i pandehuri F. S. e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se njëjta nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

Më tutje kryetari i trupit gjykues ka vazhduar me seancën e shqyrtimit fillestar për të vërtetuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat kishin me ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit të parapara në nenin 296 paragrafi 2 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit ka deklaruar: i propozojmë gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin të ketë parasysh si rrethanat lehtësuese po ashtu edhe rrethanat rënduese, po ashtu i propozoj gjykatës që duke vepruar në kuptim të nenit 296 paragrafi 6 të KPRK-së, të pandehurit të i konfiskohet kartëmonedha në vlerë prej 20€ me numër serik SF4041464562.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. K. I. ka deklaruar: pasi që i mbrojturi im e pranoi fajësinë propozoi gjykatës që të pandehurit t'i shqiptoi një dënim sa ma të butë, komfor dispozitave të KPRK-së, duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese, edhe atë së i mbrojturi im në të gjitha fazat e procedurës penale e ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje për veprën e kryer, është penduar për të njëjtën si dhe premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të këtilla apo të ngjashme penale.

I pandehuri F. S. ka deklaruar: e mbështesë deklaratën e avokatit, pendohem për kryerjen e veprës penale, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të këtilla apo të ngjashme penale, e meqë jam i pa punësuar, kërkoj nga gjykata që brenda mundësive të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

3.Konstatimet e gjykatës

Gjykata pas vlerësimit dhe shqyrtimit të provave të bashkangjitura aktakuzës lëndore, si dhe pranimit të fajësisë nga i pandehuri, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të njëjtit përmbushën të gjitha elementet e figurës së veprës penale, falsifikimi i parasë, nga neni 296 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së). Andaj, të pandehurin F. S. për veprën të përshkruar si në aktakuzën lëndore, e shpalli fajtor dhe e gjykoj me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së për të pandehurin ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë: se i

njëti e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, pendimin për veprën e kryer, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata ka pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe faktin se i njëjti përsëritës i veprave të ndryshme penale.

Andaj, gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar dhe rrethanat veçanërisht lehtësuese, është bindur se dhe me dënimin përkatës me burg në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 lidhur me nenin 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të KPRK-së, përmes të të cilit, mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, me bindje të plotë se i pandehuri do të rehabilitohet dhe se i njëjti do të parandalohet që në të ardhmen të mos kryej vepra të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, se në anën tjetër edhe qytetarët potencial do të parandalohen nga sjelljet eventuale kriminale në drejtim të dënimit apo rrezikimit të të mirave juridike të mbrojtura me të drejtën penale pozitive.

4.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale, dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale, përkatësisht me paushallin gjyqësor për të akuzuarin ka vendosur në kuptim të nenit 453 paragrafi 1 lidhur me nenin 450 ndërsa sa i përket taksës është vendosur në kuptim të nenit 39 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr.05/L036.

5.Vendimi për konfiskimin

Gjykata vendimin për konfiskimin e mur, duke vepruar në pajtim me nenin 115 paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 të KPPRK-së, e në lidhje me nenin 296 paragrafi 6 të KPRK-së.

Më sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA PKR.nr.99/2021, më datë 12.08.2022

**Zyrtarja Ligjore
Adelina Brestovci**

**Kryetari i trupit gjykues
Islam Thaçi**

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë- Departamenti i krimeve të Rënda, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:082501
Datë: 12.08.2022
Numri i dokumentit: 03321891